



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

Nr. 01 Datë 03/05 2017

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË DOKUMENTAT STANDARDE TË
TENDERIT PËR FURNIZIMIN E MALLRAVE, SHËRBIMEVE DHE KRYERJEN E
PUNËVE PUBLIKE**

Në mbështetje të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm,

Vendos:

Në Dokumentat Standarde të Tenderit për Procedurën e Prokurimit **Negociim me Shpallje Paraprake të Njoftimit të Kontratës**, për kontratat e furnizimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve publike, të miratuara me Vendimin Nr. 1, datë 22.01.2015 të Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, bëhet ky ndryshim:

1. Shtojca “Njoftim i Kontratës së Nënshkruar”, si dhe shtojca standarde e këtij formulari që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, riformulohet sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Autoritetet kontraktore, për procedurat e prokurimit që do të shpallen pas **datës 15/05/2017**, duhet të përdorin dokumentat standarde të tenderit për Procedurën e Prokurimit **“Negociim me Shpallje Paraprake të Njoftimit të Kontratës”**, për kontratat e furnizimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve publike, të miratuara me këtë vendim.
3. Ngarkohen autoritetet kontraktore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit me publikimin e këtij vendimi dhe të setit të Dokumentave Standarde të Tenderit të ndryshuara, në faqen zyrtare të internetit të APP.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM


Eduard Ahmeti

